



Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave

TW MËSOHET (NË VEND TE HUAJ) OSE JO?

**PROBLEMI I NJOHJES SË DIPLOMAVE NGA UNIVERZITETET E
HUAJA**

Përmbajtja

Hyrje		2
Pjesa 1	Aspektet juridike	8
Pjesa 2	Nostrifikim apo njohje?	12
Pjesa 3	Studim komparativ	13
Rekomandimet		15

HYRJE

Si rezultat i globalizimit, ekspanzimit si dhe internacionalizimit të procesit edukativ, të rinjtë dhe studentët ambicios nga gjithë bota kërkojnë mundësi dhe kushte më të mira për shkollim. Studentët maqedonasë e ndjekin këtë trend global kështu që mësojnë dhe studjone në gjithë botën, duke filluar nga vendet fqinje sikur Bullgaria dhe Turqia, por dhe në Kanadë dhe SHBA. Qeverisë së Maqedonisë i nevojiten ekspert kreativ të rinj të shkolluar të cilët do ta ndihmojnë vendin në procesin e integrimi Evropjane. Simonida Kacarska është njëra nga ato. Ajo fitoj stipendion nga Qeverija që të shkollohet jashtë vendit me kusht që të kthehet pas mbarimit të studimeve dhe të punojë në administratën publike që ta paguaj stipendionin. Pas diplomimit në univerzitetin e Saseksit, ajo u kthye në vend që të punoj për Qeverinë në Sekretarijatin për çështje evropjane . Megjithatë situatë është absurde - diploma e saj nuk është e pranuar në vendin tonë.¹ Simonida nuk është rast i vetëm. i ngjajshëm

¹ ¹ <http://www.a1.com.mk/vesti/default.asp?VestID=56686>

² Intervju me Vesna Garvanlievën, 27 shkurt viti 2006 .

³ Shqio përgjigjet nga pzetësorz i QHKP

⁴ Intervju me Dijana Garasovën, Qendra për informim - Ministria e arsimit, 24 shkurt,viti 2006.24.02.2006.

⁵ Ibid.

⁶ Ibid.

⁷ Apostil është fjalë franceze që do të thotë certifikat.shfrytëzohet kur bëhet fjalë për legalizimin e dokumenteve për përdoprim ndërkombëtarë me kushtet e vërtuara nga konventa e Hagës për heqjen e nevojës për legaliyimin e dokumenteve të huaja me karakter ndërkombëtarë. Dokumentet të vërtetuara në noter dhe disa dokumente tjera që pastaj janë të vërtetuar me apostil janë të pranuar për përdorim juridik në gjitha vendet që e kanë nëshkruar konventën.

⁸ Harxhime administrative që i paguhen Ministrisë së arsimit për pranimin e diplomës për fakultetin e mbaruar janë prafllsisht 15.000 denarë (reth 250 euro); për harxhime të magjistrurës janë 20.000 denarë (340 euro) dhe për doktorat 25.000 denarë (420 euro), shiqo <http://www.fzf.ukim.edu.mk/pdf/studentski/4-1-1-4.pdf>.

⁹ Çmimi i një faqe të vërtetuar në Noter është 200 denarë (3,5 euro) kurse përkthim i një faqe është 300 denarë (5 euro)

¹⁰ <http://public.mzos.hr/default.asp?gl=200503290000008&jezik=2&sid=>

¹¹ http://www.pravo.org.mk/download/Zakoni/Sub/visokoto_obrazovanie_ID25072003.pdf (25.07.2003) стр 10

¹² http://www.pravo.org.mk/download/Zakoni/Sub/visokoto_obrazovanie_ID25072003.pdf (25.07.2003) стр. 12

¹³ <http://217.16.70.245/?pBroj=2025&stID=63907&pR=3>

¹⁴ Konventa e Lisbonit

¹⁵ www.bologna-bergen2005.no/EN/national_impl/00_Nat-rep-05/National_Reports-

¹⁶ <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/021.htm>

¹⁷ <http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=021&CM=&DF=&CL=ENG>

¹⁸ <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/138.htm>

¹⁹ <http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=138&CM=&DF=&CL=ENG>

²⁰ Интервју со Дијана Гирасова, Центар за информации - Министерство за образование, 24 февруари

është dhe rasti i Vesna Garvanlieva. Ajo diplomoj dhe Magjistroj në fakultetin e Ajndhovenit dhe pastaj u kthye në Maqedoni. Mendonde se nuk do të jetë problem i madh që të pranohet diploma e saj për shkak se Fakulteti Ekonomik i Shkupit bashkëpunon me universitetin Holandez. Por, punët nuk janë ashtu të thjeshta. Universitetet Maqedonase e sjellein në pikëpyetje çështjen e validitetit të kualifikimeve të cilat kanë fituar në institucione të jashtme, Madje dhe në raste kur bëhet fjalë dhe për partner universitete. Vesna ende i grumbullon dhe i përkthen dokumentet e shumta të nevojshme, i dërgon në Holandi ku duhet oficalisht të lejohen. Kjo procedur veç më zgjat tre muaj, dhe kush e din se kur do të mbaroj. ²

Për ti pranuar diplomat të mara jashtë vendit, universitetet maqedonase shpesh kërkojnë nga kandidatët përsëri ti shkruajnë temat e tyre të diplomës ose të japin disa provime të caktuara. Në rast se standardet akademike të jenë të ndryshme nga ato të universiteteve të jashtme, egziston riziku diploma të jetë e pavlefshme. Blerim Kolalit magjistratura i ishte nënshtruar në specializim, shkallë që është më lartë se fakulteti i kryer por është më e ulët se magjistratura. Shkaqet ishin të thjeshta: Universiteti ku Blerimi ka magjistruar ka standarde të ndryshme akademike nga universiteti jonë. Fakulteti juridik është i njohur me refuzimin e kandidtëve të cilët kanë marë në gradë magjistrature në afat kohorë më pak se dy vjet, që këty krahasojnë si normë. Poashtu, tema e diplomës nuk mund të jetë e pranuar nëse është më e shkrutë se 100 faqe. Duke marë parasysh gjith këtë, shumica dhe nuk aplikojnë për pranimin e diplomave.

2006 година.

²¹ Shiko neni 34 nga ndrzshimet e Ligjit për arsim të lartëviti 2003, duke plotësuar në mënyrë efektive nen të rinumër 165, nga Ligji për arsim të lartë.

²² Në Kroaci, kriteriumet dedikohen vetëm për këtë: prodhimi përfundimtarë i studentit (dituria, aftësitë dhe kupçtimin) i dhe kompetencë; karakteristikat kryesore të progrmës akademike; akreditimi i univertyitetit të huaj dhe evaluimi i programës akademike; aktiviteti, fusha profesionale ku kandidati ka marë të drejtë të çunojë në bazë të njohjes. Kriteriumi i pestë përmend dz kërkesa plotësuese që duhet të plotësohen për njohjen e doktoraturës.

²³ Shqjo Ligjin Kroat, *Zakon o priznavanju inozemnih obrazovnih kvalifikacija*, Hrvatski sabor na sjednici 25. rujna 2003., Broj: 01-081-03-3248/2, Zagreb, 1. listopada 2003

²⁴ Sipas entit statistikorë në Kroaci, rroga mesatare neto në Kroaci është 4.686 kuni (585 euro), kurse në Maqedoni është 13.544 denarë (220 euro).

Problem i posaçëm për pranimin e diplomave janë dhe studimet multidisiplinare apo interdisiplinare. Ata janë shumë të rallë në Maqedoni, por të zakonshme në Evropë. Studentët Maqedonasë marrin studime për nacionalizëm, studime për të drejtat e njeriut dhe studime për minoritete ose studime për tolerancë. Duka marrë parasysh se këta programa akademike nuk ekzistojnë në vendin tonë, studentët kanë problem më njohjen e diplomave në vend.. Zhidas Dasklaovskit magjistratura i ishte pranuar pas gjashtë viteve orvajtjeve për të kaluar barrierat byrokratike. Asnjë katedër nuk shtroheshte si complete për të ta vlerësuar aplikimin. Në fund ishte formuar komisioni i veçantë në krye me ministrin për arsim, Komisioni e shqirtoj dhe e vlerësoj si positive aplikimin. Është interesant se Zhidasi mbrojti doktoraturën në univerzitet të huaj para se magjistratura e tij të ishte pranuar në Maqedoni. Për fat, procesi i pranimin të doktoraturës zgjati vetëm një vjet.

Në rast të mos ekzistojnë në Maqedoni institute më të lartë arsimore e cila është “e cila është complete për të vlerësuar diplomën që është fituar në vend të huaj, ministria duhet të themelojë komision të posaçëm prej 3 profesorëve që do të bëjnë atë” Kjo ishte e mundur me ndryshimet e nenit 168-a nga Ligji për shkollim të lartë nga viti 2003. Kjo mundësi duhet ta lehtësojë procesin e pranimin të diplomave për programet multidisiplinare. Por në praktikë ende ekzistojnë probleme. Shumë studentë madje dhe nuk din për këtë ndryshim të Ligjit- shkak mund të jetë joefikasiteti i tij në praksë. Dijana Despodova, me diplomë nga programa multidisiplinare, sqaroi se në Maqedoni” nuk do të drejtohem, nuk ka mekanizma për pranimin e këtyre diplomave” Ajo e mbroj tezën e saj të magjistraturës në katedrën e studimeve të evropës juglindore në Univerzitetin e Evropës-Qendrore në Budapestë, programë e cila nuk ka ekuivalencën e saj në Maqedoni..

Respektivisht, shumë studentë maqedonasë të cilët shkollohen jashtë vendit kanë problem më pranimin e diplomave të tyre kur kthehen në vendin tonë. Në bazë të hulumtimit të pamvarur dhe pyetorë që u ishte shpërndarë studentëve që kanë diplomuar jashtë, Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave i identifikojë problemet me të cilët ballafaqohen studentët në procesin e pranimin të diplomave të tyre nga ana e institucioneve maqedonase. Edhe pse ekzemplari ishte realtivisht i vogël 60 studentë maqedonas nga gjithë bota, mirpo gjendjen përgjigjet e ilustronë. Rreth 70% nuk kanë as provuar për pranimin e diplomave të tyre, 20% ende presin përgjigje nga Ministrija për Arsim. Vetëm 10% nga këto studentë maqedonas, me

diploma nga univerzitetet e popullarizuara siç është London School of Economics dhe Univerziteti në Kembrixh, u janë pranuar diplomat , por dhe ajo me procedura të gjata deri më 12 muaj.

Disa të rinjë as nuk mundohen ti veifikojnë diplomat e tyre. Për to problem kryesorë është zgjatja e procedurës. Procedurat e gjata byrokratike të komplikuara dhe të shtrenjta, lista e gjatë e dokumenteve të nevojshme dhe mundimet të ndryshme administrative na bëjnë pishman thonë studentë. Studentët poashtu ankohen se thjshtë më “lidhje” mund të fitohet njohja e diplomës. Është alarmant fakti se shum të rinjë dhe qytetarë maqedonas nuk janë optimist për rezultatin e procedurës para se të aplikojnë për pranimin e diplomës.


Situata e tillë është hendikep jo vetëm për studentët te cilën janë të kapluar dhe të cilët ballafaqohen me problem kur kërkojnë punë në sektorin public, por edhe për vendin që nuk i shfrytëzon diturin e tyre dhe aftësit të përvetësuar jashtë, dhe atë shpesh të univerziteteve me reputacion të mirë. Për shkak të procesit të gjatë dhe të mundishëm të pranimit të diplomave, shum nga studentët zgjidhjen kërkojnë në sektorin privat, organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare kur diplomat e tyre kanë përparësi. Sipas rezultatëve të hulumtimit tonë, 50% nga të pyeturit janë të punësuar në sektorin joqeveritarë, 30% në sektorin privat, kurse të tjerët janë të papunësuar.

Përveç komplikimit gjatë kërkimit të punës prezen poashtu janë problem reth zgjatjes së shkollimit në univerzitetet maqedonase. E drejta e studentëve për mësim të përjetshëm është prishur. Mësimi I përjetshëm promovohet në tre deceniet e fundit dhe rezulton më zhvillim të shpejtë ekonomik dhe teknologjik në shoqëritë të cilat janë të orientuara në përfitimin e njohurive të reja. Ky koncept, që secilit individ I mundëson proces të kontinuar për mësim gjatë gjithë jetës, patjetër duhet të jetë I kapshëm për gjithë qytetarët maqedonas. Mundësija që të shpërblehen aftësitë profesionale është një nga principet themelore të deklaratës së Bolonjës për shkollim të lartë. Ai princip i është ndërprerë këtyre studentëve. Ata nuk mund të fitojnë tituj akademik, as fliksibilitet professional në tregun e dkrahut të punës.

Sipas ministrisë së arsimit, problemi i pranimit të diplomave të maranë vend të huaj lindin kur studenti ka mësuar në vend me të cilin Maqedonia nuk ka marveshje bilaterale.


Diploma të pranuar sipas vendit (të dhëna për periudhën 03.06.2002-1ç.12.2005)

Bullgaria, Shqipëria, Turqia, vende tjera, Ende duke pritur



Raporti I diplomave të pranuar

Proportion Of Recognized Foreign Diplomas



Edhe pse nuk egzistojnë marveshje bilaterale me Kosovën, Romaninë dhe Hollandinë, diplomat që janë marë në këto vende më shumë pranohen. Por këto janë rastë veçanta. Siç tregojne shifrat në grafikonet më lartë, numri i diplomave të pranuar me vendet që nuk ka marveshje bilaterale është shumë i vogël. Në momentin.5, reth 300 aplikime janë në process të shqyrtimit për pranimit të diplomave.

ASPEKTET JURIDIKE

Ligji për shkollim të lartë e përmban çështjen e njohjes së diplomës të cilat janë të mara në vend të huaj. Qendra për informim është organ në kuadër të Ministrisë së arsimit që u ndihmon studentëve me diploma të huaja të fitojnë të fitojnë pranimin-njohjen të kualifikimeve të tyre në Maqedoni. Qendra vetëm e lehtëson procesin e pranimin. Ata e dërgojnë aplikimin në komisionin adekuat në fakultetin përkatës i cili e vlerëson dhe përcakton shkallën e kompaktibilitetit me sistemin arsimorë maqedonas. Procedurata është komplikuar, Është nevojshme të parashtrihen shumë dokumente. Komision madje dhe mban të drejtën të kërkojë dokumente shtuese. Gjatë dërgimit të aplikimit në Qendrën për informim, kandidati duhet ti dërgoj dokumentet vijuese.

Dokumenti	Harxhimet e kandidatit
Diplomë origjinale dhe apostil nga vendi	reth 100 euro
Fotokopje të vulosura (3 ekzemplarë) të diplomës origjinale	600 denar - 10 euro
Fotokopje e dokumenteve plotësuese dokumente të kërkuara nga ministria për arsim	reth 10 euro
Përkthim official I diplomës në gjuhën maqedone	300 denarë - 5 euro
Përkthim official në maqedonisht I fotokopjeve të vulosura të diplomave/magjistraturës/doktoraturës	600 denar - 10 euro
Fotokopje e vulosur e diplomave të të mara në Maqedoni para studimeve në vend të huaj ;	300 denarë - 5 euro
Aplikim në ministrinë e arsimit më kërkesë për pranimin e diplomës.	250 Denarë - 5 euro
Deklaratë personale e kandidatit	Reth 5 Euro
Fotokopje e letërnjoftimit ose pasaportës	Më pak se 1 euro
Përkthim I autorizuar I planit arsimorë dhe programa e studimeve akademike, si dhe përkthim I autorizuar I magjistraturës ose doktoratit	Reth 25000 Denarë - 600 evpa
Deklaratë personale e nënshkruar nga kandidati	Deri 5 euro
TRANSKRIPT nga univerziteti	Deri 30 euro
“Harxhime administrative” të padefinuara	ç500 Denarë - 75 euro
Taksë për dhënien e sertiifikatës me të cilën pranohet diploma	Deri 25000 denarë- ç20 euro8
Harxhime të përgjithshme	Reth 1280

Është e qartë se është shumë shtrenjtë të sigurohen të gjithë këto dokumente. Më tutje, të gjitha duhet të jenë vulosura dhe oficalisht të përkthyer⁹. Për dallim nga Bullgaria dhe Kroacia, studentët maqedonas duhet të kenë përkthim të autorizuar të temave të diplomës/magjistraturës/doktoraturës. Në vijim të asaj se temat e magjistraturës dhe të doktoraturës janë dokumente të mëdhaja, vetëm harxhimet për përkthimin e tyre do të ishin shumë mëdhaja. Repsektivisht pranimi i diplomës në Maqedoni është më shtrenjtë në krahasim me vendet tjera nga regjioni- harxhimet e përgjithshme mund të arrijnë deri më 1280 Euro! Gjithë këto para për një pjesë të vogël letre më vulë dhe nënshkrim nga ministrija me të cilën Simonida pranohet si magjistër i politikës evropjane në Maqedoni. Për dallim, në Kroaci procedura e njëjtë kushton vetëm 65 euro.¹⁰

Kur dokumentet do të jepen në Ministrinë e arsimit, procedura për njohjen fillon me vlerësimin e dokumenteve nga Qendra për informim. Në katedrën e cila është ekuivalente ose e ngjajshme me atë ku kandidati I ka mbrojtur temën I tij, formohet komision për vlerësim/evaluim. Afati përfundimtar i komisionit për evaluim formal është 3 muaj nga momenti I pranimit të dokumenteve.¹¹ Komisioni ka të drejtë të kërkojë “ Mendim plotësues” nga Qendra për informim në lidhje me gjitha aspektet që janë të rëndësishme për objektivitetin e zgjidhjes. Afati përfundimtarë i Qendrës për Informim për ti dorëzuar informatat e dhura është 30 ditë.¹²

Vendimi për aplikimin është nënshkruar nga kryjetari dhe anëtarët e komisionit. Por zgjidhjen përfundimtare e sjell ministrija e arsimit. Ai/ajo vlerëson se a ka qenë në përputhshmëri me Ligjin procedura e njohjes. Në praktikë, është joefikase dhe e gjatë. Rrallë herë ndodh që vendimet për njohjen e diplomave të sillen në afatet kohore të parapara me Ligj. Sipas informative që morëm nga studentët që u përgjigjen pyetsorit, procedura zgjat reth 12 muaj. Me këtë Ligj nuk rregullohet mundësia për parashtrësë nga ana e kandidatit në rastë se procedura të zgjatë më shumë se sa me ligj është paraparë. Në rast afati I fundit të kalohet, Ministrija është e detyruar të emëroj fakultet/univerzitet tjetër të zbatoj procedurën.

Zgjatja e procedurës administrative I dedikohet kohës që i nevojitet Qendrës për informim të kontrollojë se a janë valide ata dokumente të dërguara. Qendra e provon

kredibilitetin e univerzitetit që e ka dhënë diplomën. „ Deri sa nuk fitojmë vërtetim nga univerziteti, nuk mund ta ndjekim rastin deri në komisionin për revision, detyra e së cilës është të bëj krahasimin e programës studjuese dhe ti rikthej dokumentët në MInistrinë ku zgjidhjen përfundimtare e sjell ministri.“¹³ Në praktikë, kontrolla se se a është legal univerziteti që ka dhënë diplomën bëhet nëpërmjet postës elektronike. Në procesin e njohjes së magjistraturës, Marija Risteska u njoftua se dokumentet oficiale të përkthyer dhe vula nga univerziteti i saj nuk ishin të mjaftueshëm. Për të kryer punën duheshte përgjigje positive dërguar në postë elektronike (e-mail) kërkesë deri tek sekretari i katedrës për Administratë publike Evropjane dhe politikë publike në univerzitetin Katolik në Luven, Belgjikë.

Ligji për shkollim të lartë nuk e regullon në mënyrë precise pozicionin dhe përgjegjësinë e Qendrës për Informim në sistemin e njohjes së diplomave. Detyrë e Qendrës për informim është ti paraqes gjitha dokumentet deri në komisionin i cili pastaj e pregadit mendimin për aplikimin e kandidatit. Qendra nuk është e kufizuar në afat kohorë për ta vërtetuar se a është autentik dokumentacioni. Kjo është një nga arsyet për procedurë byrokratike për njohjen e diplomave të marë jashtë vendit. Si rezultat, procesi i njohjes zgjat 12 muaj. Periudha e këtillë e gjatë e cila është e vërtetuar në Ligjin maqedonas dhe e implementuar nga qeveria nuk është në përputhshmëri me Konventën e Lisabonit për njohjen e diplomave që është ratifikuar nga Maqedonia në shkurt të vitit 2002. Në Konventë shumë qartë deklarohet për procedurë të lehtë dhe transparente në interval të arsyeshëm kohorë.

Neni III.5

“Zgjidhjet për njohjen duhet të sillen në kornizë të arsyeshme kohore, më parë e vërtetuar nga organ kompetent dhe e llogaritur nga momenti i fitimit të gjitha informatave të nevojshme në rastin e duhur. Në qoftë se vendimi është negativ, arsyet për refuzim duhet të përmenden, si dhe informatat e duhura për hapat e mëtutjeshme që kandidati duhet të mer për tju pranuar diploma në të ardhmen. Në qoftë se vendimi është negativ ose nuk është sjellur, kandidati ka të drejtë për ankesë në interval të arsyeshëm kohorë.“¹⁴

Procedurat në Maqedoni nuk janë në përputhshmëri as me detyrimet nga deklarata e Bolonjës-Bergen që kanë për qëllim të krijojnë sferë Evropjanë të shkollimit të lartë

(European Higher Education Area-EHEA) deri më vitin 2010 dhe thonë: „ qëllimi i përforsimit të rolit të krijimit të politikave në nivel univerzitarë, udhëheqje institucionale. Qasje të mundshme e të gjitha grupeve etnike, garancë për kualitetin dhe zbatimin e reformave strukturale duke i inkuadruar dhe sistemin e gradimit dhe kredit transfer sistemin.“¹⁵

Marveshje tjera Ndërkombëtare që janë relevante për problemin tonë janë konventat për ekuivalencë për periudhën e studimeve:

- Konventa Evropjane e të qenurit ekuivalent e periudhës së studimeve 16- e sjellur në Paris më 15 dhjetorë të vitit 1956, një nga vendet që e ka ratifikuar këtë konventë është edhe Maqedonia, më 30 mars të vitit 1994.¹⁷
- Konventa Evropjane për ekuivalencë gjenerale e periudhës së studimeve 18- e sjellur më 6 nëntorë të vitit 1990 në Romë. Maqedonia¹⁹ nuk e ka nënshkruar këtë konventë.

Dy konventat japin dy drejtime gjenerale. Qëllimi kryesor i këtyre konventave është të parashtroj kornizën themelore në këtë fushë specifike të shkollimit terciar. Disa nga pikat kryesore të konvencionit nga viti 1956 të cilën Maqedonia e ka ratifikuar janë: Vendet që kanë ratifikuar këtë Konventë duhet të mundësojnë pranimin e kohës së studimeve në univerzitet tjetër në vendin anëtarë të Këshillit Evropjan si ekuivalente me periudhën e studimeve në univerzitetin vendorë (neni 2); Provimet që studenti i ka dhënë ose kurset që i ka ndjekur gjatë kohës së studimeve në univerzitetin vendi i së cilës është vend-anëtarë e Këshillit Evropjan mund të llogariten si ekuivalent me ato provime dhe kurse në universitetin vendas (neni 3). Por komisioni Evropjan për të qenurit ekuivalent për periudhën e studimeve vlen për fushën e gjuhëve moderne. Konventa evropjane për të qenurit ekuivalent gjenerale e periudhës së studimit nga viti 1990 ishte rezultati i kërkesës të gjeneralizohen këta kushte dhe për fushat tjera, në vijim të asaj se shumë studentë nga më shumë fusha tjera kanë nevojë provimet e tyre dhe kurset të pranohen nga ana e univerzitetëve të tyre amë. Për fat të keq, Maqedonia nuk është ndër vendet që kanë nënshkruar dhe ratifikuar këtë konventë.

Më lehtë e kanë vetëm ata studentë që kanë studjuar në vendet me të cilat Maqedonia

ka nënshkruar marrëveshje bilaterale -në rastet e tilla njohja e diplomave është e detyrueshme. Maqedonia ka nënshkruar marrëveshje të tilla me tre vende- Shqipërinë, Bullgarinë dhe Turqinë. Është e qartë se nuk është situatë më e mirë dhe nuk i vendos të gjithë në pozicion të barabartë. Madje, për shkak se shumë studentë kanë diploma nga Shqipëria dhe Bullgaria, qeveritarët janë të detyruar ta kontrollojnë se sa janë valide ato diploma. Sipas Qendrës për informim, Ministrija e arsimit ka për qëllim të nënshkruaj marrëveshje bilaterale me vendet e ish Jugosllavisë.²⁰

2

NOSTRIFIKIM APO NJOHJE?

Egzistojnë njëjans në sistemin e “nostrifikimit” ose pranimit të diplomave të huaja së të barabarta me ato vendore, dhe njohjen e diplomave të huaja. *Nostrifikim* është eprocedurë gjatë së cilës caktohet se a është diploma e huaj e barabartë me të njëjtën diplomë që jepet në vend. Në qoftë se studenti ka magjistruar në Holandë, provimet që i ka kaluar dhe metodat e përgaditjes së temës së diplomës krahasohen me ato të njëjtat në Maqedoni. Në rastin kur provimet nuk përputhen, studenti duhet të jep ato provime që mundojnë. Në qoftë se tema e maturës ka më pak faqe se standardet e parapara në vend, atëherë studenti duhet përsëri të shkruaj temën. Çështja kryesore është kompaktibiliteti i di institucioneve të larta arsimore i dy vendeve. Në rastet kur bëhet fjalë për pranimit të diplomave të huaja, vendi amë e barazon statusin juridik të diplomës së huaj me atë që jepet në vend. Domethënë, nëse studenti magjistron jashtë vendit, institucionet vendore vetëm duhet të provojnë së a është dhënë diploma nga institucioni i pranuar arsimorë. Në qoftë se gjithçka është në rregull atëherë studentit i pranohet shkallë e njëjete që i ka fituar jashtë, pa nevojë që të përsërit provimet ose përsëri të shkruajë temën e magistraturës-diplomës.

Edhe pse Ligji maqedonas për arsim të lartë, në mënyrë eksplicite i dedikohet pranimit të diplomave të huaja,²¹ në praktikë sistemi i vjetër për nostrifikim ende ka ndikim të madh. Kur diploma duhet të pranohet, kriterium për njohjen e saj është kompaktibile me sistemin e arsimit të lartë të arsimit të lartë në vendin e huaj me atë vendorë. Ky është rezultat i kushteve komplekse juridike që duhet të revidohen që diploma të pranohet. Neni 175 dhe 176 Nga Ligji sqaron se gjatë pranimit të diplomave të huaja ekzistojnë disa çështje që duhet të shqyrtohen siç janë lloji i sistemit të shkollimit në vendin e huaj, dallim i përgjithshëm me sistemin vendorë, a është i

akredituar në vendin e huaj institucioni I lartë arsimorë, kushtet për pranim në institucionin e lartë arsimorë, programi akademik(plani arsimor) I institucionit të lartë arsimorë, plan programi I lëndëve që mësohen, koha e mësimit të çdo lënde, sistemi I vlerësimit, zhvillimi I sistemit të akreditimit dhe sistemi I evaluimit në vendin e huaj e tjerë.

Në bazë të kushteve të caktuara më Ligjin maqedonas, njohja e diplomave të huaja është shumë më I ngajshëm me sistemin e nostrifikimit se sa me sistemin e njohjes. Për fat të keq, kompaktibiliteti I sistemit arsimor ende vlen kriteriumi për njohjen e diplomave të huaja në Maqedoni.

3

STUDIM KOMPARATIV

Në Kroaci, Ligji numëron vetëm pesë kriteriume të cilat duhet të plotësohen për njohjen e diplomave të huaja- në Maqedoni janë pesëmbëdhjetë²² Deri në përvetësimin e Ligjit për njohjen e kualifikimeve të huaja arsimore më vitin 2003 I cili filloj të zbatohet me vitin 200ç, Kroacia e shfrytëzonte sistemin e nostrifikimit të diplomave të huaja. Përgjegjësinë kryesore për pranimin e diplomave të huaja e ndërmoi univerziteti I Zagrebit. Nga viti 200ç Kroacia e shfrytëzon sistemin e pranimit të diplomave të huaja, duke barazuar vlerën e diplomës së marë jashtë me atë në Kroaci. Kroacia ka Ligj të veçantë²³ i cili e regullon çështjen e nostrifikimit të diplomavekojtë huaja. Në bazaë të atij Ligji, Agjencioni për shkencë dhe arsim të lartë është përgjegjshme për pranimin e këtyre diplomave.

I ngajshëm me Ligjin aktual maqedonas, Agjencioni e sjellë vendimin e saj me vlerësim nga dokumentacioni I parashtruar nga ana e kandidatit dhe rekomandimet nga Qendra për informim (zyra nacionale ENIC/NARIC). Dokumentacion e vlerëson komision profesional. Afati I parashtrimit të evaluimit në Qendrën për Informim është 60 ditë. Në qoftë se afati tejkalohet, ajo automatikisht paraqet aprovim I kërkesës. Më tutje, Qendra kroate për Informim duhet në afat prej 8 ditësh ti jep rekomandim Agjencionit për shkencë dhe arsim të lartë për vendimin përfundimtarë. Nga momenti I fitimit të rekomandimit, Agjencioni ka 8 ditë të sjellë vendimin përfundimtarë.

Sipas Ligji kroat kriteriumet kryesore duhet qenë njohuritë dhe aftësitë që studenti ka fituar në institucionin e lartë arsimorë të huaj. Kompaktibiliteti I plan programit

arsimorë në Kroaci dhe në vendin ehuaj ku është fituar diploma nuk është kusht në procesin e evaluimit. E gjithë procedura, e cila është relativisht e lirë dhe kushton 600 kuna kroate (65 euro), është e thjeshtë dhe e shpejtë, procesi nuk zgjat më shumë se 3 muaj. Procedurata poashtu është efikase. Nga 1 korriku i vitit 2005 deri më 12 qershorë të vitit 2006, Agjencioni ka pranuar 2.182 aplikime për pranimin e diplomave të huaja, 1.750 (87%) kanë qenë të pranuar, kurse 27 (1,2%) kanë qenë të refuzuara. Shumica e studentëve aplikacionet e të cilave kanë qenë të refuzuara kanë studjuar në univerzitetet që nuk kanë qenë të akredituara.

REKOMANDIME

- *Revizion I kushteve për njohje.* Sfida më e madhe është krijimi I sistemit të njohjes së diplomave në në kuptimin e plotë të fjalës, system I cili do ti jep fund nostrifikimit që më se shumti zbatohet në praktikë. Edhe pse në Ligjin përmendët sistemi I njohjes, ende zbatohen procedura e nostrifikimit. Këtu egzistojnë disa pengesa juridike. Për shembull, kompaktibiliteti I programeve akademike përmendet si kriterium I rëndësishëm për njohje të diplomave. Mendojmë se numri I kushteve që duhet te plotësohen patjetër duhet të reduktohet. Të gjitha kushtet që I dedikohen kompaktibilitetit të sistemit të lartë arsimorë duhet të menjanohen. Ligji duhet të vërtetoj kriteriumin kryesorëpër njohjen e diplomave, kurse ai duhet të jetë njohuria dhe aftësitë që studenti ka fituar.
- Me qëllim që të shmangen procedurat e gjata për njohjen e diplomave të cilat në shumicën e rasteve I tejkalojnë afatet kohore të parapara me Ligj, QHKP rekomandon të ndiqet shembulli dhe përvoja e Kroacisë. Ligji duhet të ketë nën I cili do të përcaktojë sjellje e vendimit në mënyrë automatike në rastë se vendimi tejkalimit të afateve kohore nga ana e komisioni I autorizuar. QHKP është e mendimit se kjo do të kishte kontribuar për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë për kryerjen e punëve në administratën publike dhe për zmadhimin e efikasitetit për zbatimin e Ligjit në interes të individëve të rezikuar.
- Kornizat kohorë për dorëzimin e evaluimit të dokumentacionit nga ana e Qendrës për Informim deri në komisionin duhet të regullohen me Ligj. Qendra për Informim duhet komisionit ti dërgojë informata detale. Komisioni duhet të kërkojë informata plotësuese për atë se a është I akredituar univerziteti I caktuar .
- Duhet të nënshkruan marrveshje bilaterale me vendet prej nga vinë më shumë për njohjen e diplomave (marrveshja me Romaninë duhet të ripërtrihet).
- Duhet të zvoglohet numri I dokumenteve të cilët janë për njohje dhe të silltet në minimumin e nevojshëm. Me atë do të ishin zvogluar edhe harxhimet. Zvoglimin e numrit të dokumenteve të nevojshme për aplikim mundët lehtë të zbatohet me revision juridik I “ kushteve për pranim”. QHKP u rekomandon pushtetit ti zvoglojnë harxhimet e larta fjetë procedurës për atë se madje në vendet me standard më të lartë nga Maqedonia (shembull Kroacia) kanë procedura më të lira administrative.²⁴

